



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

| | | |
|----------------|--|---------------------|
| Për : | Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë | |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL | |
| Përmes: | Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 08/05/2019 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë | 020-18914 |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi nr. 01-410/03-448 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.01-410/03-71 të datës 08.02.2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

E miratuar më datë më datë: 30.04.2019

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.05.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

30.04.2019

01-410/03-71,8

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12 shkronja d. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/1008), dispozitive të nenit 10 shkronja d. të Ligjit Nr. 04/L-076, për policinë, dispozitive të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 10 shkronja d. të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë mbledhjen e mbajtur më datën 30.04.2019, merr këtë:

| | | |
|---|------------|-----|
| Kuvendi i Komunës së Vitisë | | |
| Ministry of Local Government Administration | | |
| Data | 02.05.2019 | |
| Titulli | | |
| Titulli i Organizatës | Adresa | Web |
| 01-410-189/4 | | |

V E N D I M

Për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për ndryshim plotësimin e Vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë.

Neni 2

Konformë nenit 1 të këtij vendimi, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë, anëtarin me numër rendor 2, z.Agim Lipovica, ish komandant i Stacionit Policor në Vitë, zëvendësohet me z.Ahrim Halilin, komandant i Stacionit Policor në Vitë.

Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë mbeten në fuqi.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Sherbimi të Kuvendit,
2. Anëtarëve të KKSBB-së,
3. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U R I

Naïm Pira

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKATA
KOMUNA E VITISË - OPËTINA VITI

| | | | |
|--------------------------|--------------------------|-----------------------|--------------------|
| 08-02-2018 | | | |
| Nr. i aktit (titulli) | Nr. i aktit (titulli) | Shprehja (titulli) | Vlera (titulli) |
| 01-410/03-71 | | | |



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L - 076, për policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr 27/2012 MPB, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 36 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011. Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.01.2018, merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Neni 1.

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka këtë përbërje:

1. Sokol Haliti, kryetar i komunës, Kryesues i KKSb,
2. Agim Lipovica, Komandant i Stacionit të Policisë në Viti, anëtar,
3. Nexhmedin Jakupi- Drejtorja për SH.P dhe Emergjencë, anëtar,
4. Ibadete Hyseni, zyrtare për Barazi Gjinore, anëtare,
5. Qahil Sinani- drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar,
6. Zoran Marinković, përfaqësues i zyrës komunale për komunitete dhe kthim, anëtar,
7. Radovan Gjuriç, përfaqësues i komiteti për komunitete,
8. Ali Vishi, përfaqësues i FSK-së, anëtar
9. Xheladin Halili, përfaqësues i Bashkësisë Islame në Viti, anëtar,
10. Zef Marku, përfaqësues i Bashkësisë Katolike në Viti, anëtar,
11. Millosh Vukiç, përfaqësues i Bashkësisë Ortodokse në Viti, anëtar,
12. Xhemajl Hasani, përfaqësues i bizneseve të Komunës së Vitisë, anëtar,
13. Blerina Muharremi, përfaqësuese e mediave lokale, anëtare,
14. Taulant Sejdiu, OJQ "Elita" anëtar,
15. Adnan Zenuni, Kryetar i komitetit lokal të qytetit të Vitisë, anëtar,
16. Bujar Ostërgllava, Kryetar i komitetit lokal të fshatit Pozheran, anëtar,
17. Imri Sahiti, Kryetar i komitetit lokal të fshatit Smirë, anëtar,
18. Imri Emërllahu, përfaqësuesi i Ekipit veprues për siguri në Bashkësi
19. Zeqir Sadriu, kryetar i këshillit të prindërve.

Neni 2.

Detyrat dhe funksioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi numër 27/2012 të MPB dhe 03/2012 të MAPL-së.

Neni 3.

KKSB është organ Këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të një komune.

Neni 4.

Gjatë themelimit të KKSB janë marr parasysh kriteret e përfaqësimit gjinor, përfaqësimi i drejtë i të gjitha bashkësive etnike dhe fetare.

Neni 5.

Mandati i anëtarëve të KKSB është mandat i njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal Ditën e hyrjes në fuqi të këtij propozim vendimi shfuqizohet Vendimin nr 01-013/267 i datës 28.02.2014 për formimin e Këshillit Komunal për siguri në bashkësi të Komunës së Vitisë.

Neni 6.

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 7.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81. Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit
2. Anëtarëve të KKSB-së
3. MAPL
4. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Naim Pira

